



Programi IPA 2010 i Bashkimit Evropian për Shqipërinë

***Asistencë Teknike për Forcimin e Kapacitetit të
Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të
Ujërave në Hartimin e Ligjeve dhe Detyrimin e
Legjislacionit Kombëtar Mjedisor***

(EuropeAid/I30987/C/SER/AL)

**Dokument mbi Organizimin e Ri të ISHM
(VKM 476, 16.6.2011)**

Aktiviteti B.1:

Struktura e Inspektoratit Shtetëror Mjedisor

Draft



**Ky projekt është financuar
nga Bashkimi Evropian**

Titulli i Projektit: Asistencë teknike për forcimin e kapaciteteve të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave të Shqipërisë për hartimin e ligjeve dhe detyrimin e legjislacionit kombëtar mjedisor.

Numri i Projektit: Europe Aid/130987/C/SER/AL

Numri i Kontratës 2011/275-693

Vendi: Republika e Shqipërisë

| | Përfituesi | Kontraktori |
|-------------------------|--|--|
| Emri: | Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave | Grontmij A/S |
| Adresa: | Rr. Durrësit, Nr 27, Tirane, Shqipëri | Granskoven 8 DK-2600 Glostrup |
| Person Kontakti: | Enkelejda Malaj | Paolo Bacca |
| Telefon: | +355 4 2270621/2 | +355 4 2226493 |
| E-mail: | enkelejda.malaj@moe.gov.al | Paolo.Bacca@selea.al |
| Data e Raportit: | 10 Korrik 2012 | |
| Titulli: | Organizimi i ISHM-së | |
| Autorët: | Scott Crossett; Breda Howard; Gjergji Selfo; Paolo Bacca | |

Mirënjohje

Grupi i punës së këtij projekti dëshiron të shprehë mirënjohjen e tij ndaj të gjithë personave dhe eksperteve nga të gjitha institucionet dhe ndaj aktorëve të interesit të përfshirë në sigurimin e të dhënave dhe informacionit si dhe ndaj të gjithë personave dhe institucioneve, të cilët kanë mbështetur përgatitjen e këtij Raporti. Falënderime të veçanta i jepen Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, si dhe Drejtorisë së Kontrollit Mjedisit.

Ky raport është përgatitur nga ekipi i projektit, i cili ka punuar për Grontmij. Gjetjet, konkluzionet dhe interpretimet e shprehura në këtë dokument janë vetëm të Grontmij, dhe nuk duhet të përdoren në asnjë mënyrë si pasqyruese të opinionëve dhe të politikave të Komisionit Evropian.

TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E SHKURTIMEVE

| | Faqe |
|---|-------------|
| HYRJE | 3 |
| 1 STRUKTURA AKTUALE E PËRGJITHSHME E IM-SË | 5 |
| 2 PROPOZIM PËR NJË STRUKTURË TË RE ORGANIZATIVE TË ISHM-së | 6 |
| 1.1. STRUKTURA E PËRGJITHSHME PËR ISHM-në | 6 |
| 1.2. PËRSHKRIMI I DREJTORIVE | 8 |
| 1.3. ANALIZAT SASIORE TË NEVOJAVE PËR PUNONJËS | 10 |
| 1.4. PËRSHKRIMET E DETYRAVE DHE NDIKIMET NDAJ PERSONELIT | 14 |
| 1.5. NDIKIMET FINANCIARE | 15 |
| ANEKSI A PËRSHKRIMET E VENDIT TË PUNËS | 16 |
| ANEKSI B PASOJA FINANCIARE TË ISHM-së së RISTRUKTURUAR | 23 |
| ANEKSI C LISTA E PERSONELIT AKTUAL TË IM-SË | 24 |

LISTA E SHKURTIMEVE

| | |
|-------|--|
| VKM | Vendim i Këshillit të Ministrave |
| DAP | Departamenti i Administratës Publike |
| IM | Inspektorati i Mjedisit |
| QSH | Qeveria Shqiptare |
| SQ | Seli Qendrore |
| BNJ | Burime Njerëzore |
| MMPAU | Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave |
| ARM | Agjenci Rajonale e Mjedisit |
| IRM | Inspektorate Rajonale Mjedisore |
| ISHM | Inspektorati Shtetëror Mjedisor |
| SELEA | Forcimi i detyrimit të legjislacionit mjedisor në Shqipëri |

HYRJE

Inspektorati i Mjedisit (IM) funksionon sot në nivel qendror nën Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU) si një sektor i Drejtorisë së Kontrollit të Mjedisit. Sidoqoftë, MMPAU ka organizuar ARM-të aktuale në dy sektorë: një sektor i përbërë prej ekspertesh të mjedisit, të cilët merren me Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, informacionin, raportimin etj; dhe sektori tjetër i përbërë prej inspektoreve të mjedisit. Kështu, të dyja ARM-të dhe IRM-të aktualisht funksionojnë në 12 agjenci, të cilat veprojnë në nivel qarku, por që janë nën varësinë e Ministrit të Mjedisit.

Detyrat dhe funksionet aktuale të inspektoratit të mjedisit janë të përcaktuara nga VKM Nr. 24, datë 22.01.2004 "Për organizimin e inspektoratit të mjedisit", i cili bazohet në Ligjin 8934/2002 "Për Mbrojtjen e Mjedisit". Sidoqoftë, ky ligj do të shfuqizohet pas datës 30 Janar 2013 nga Ligji Nr. 10431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", dhe VKM Nr. 24 nuk do të jetë më në fuqi.

Ligji i ri Për Mbrojtjen e Mjedisit përcakton funksionet dhe përgjegjësitë e reja të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit (ISHM):

- a. *Autoritetin kompetent për të siguruar kontrollin shtetëror ndaj mbrojtjes së mjedisit siç përcaktohet nga ky Ligj, dhe prej legjislacionit të referuar në vijim;*
- b. *Autoritetin kompetent për të siguruar zbatimin e kushteve të çdo leje të mjedisi në përputhje me përcaktimet e këtij Ligji dhe legjislacionit në fushën e lejeve të mjedisit;*
- c. *Autoritetin kompetent për përgatitjen e programeve vjetore të inspektimit dhe sigurimin e zbatueshmërisë së tyre;*
- d. *Sigurimi i informacionit për publikun mbi çështjet e mjedisit në përputhje me përcaktimet e këtij Ligji;*
- e. *Sigurimi i informacionit për publikun lidhur me procesin e vendimmarrjes mbi çështjet e mjedisit në përputhje me përcaktimet e këtij Ligji;*
- f. *Autoritetin rregullator për sigurimin e zbatueshmërisë së parimit të përgjegjësisë mjedisore në përputhje me përcaktimet e këtij Ligji;*
- g. *Kryerja e kontrolleve për zbatimin e detyrimeve, hetimin e pikave të ndotura apo potencialisht të ndotura, si dhe detyrat e programet e rehabilitimit të pikave të ndotura. Inspektori i mjedisit mund të kryejë gjithashtu detyra të tjera të përcaktuara në ligje të tjera të veçanta të lidhura me mjedisin;*
- h. *Çdo funksion tjetër të përcaktuar në ligjet e tjera të veçanta për mjedisin.*

Megjithëse Ligji Nr. 10431, dt. 9.6.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" përcakton detyrat dhe funksionet e ISHM-së, është një tjetër ligj, i cili detajon rregullat e organizimit dhe funksionimit të Inspektoratit të Mjedisit.

Faktikisht, ndarjet dhe organizimi i punës, statusi i punonjësve dhe marrëdhëniet me institucionet e tjera, janë të përcaktuara në Ligjin Nr. 10433 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë" i cili hyri në fuqi më 16 Qershor 2011.

Ligji mbi inspektimin përcakton parimet e përgjithshme të inspektimit, dhe organizimin e institucioneve publike, të cilat zbatojnë funksione të inspektimit, statusin e inspektoreve, rregullat për inspektimin, procedurat administrative si dhe krijimin dhe funksionet të Inspektoratit Qendror.

Inspektorati Qendror përbehet nga inspektorati shtetëror dhe nga inspektoratet lokale. Inspektori i Përgjithshëm, i cili është drejtues i Inspektoratit Qendror, emërohet nga Kryeministri.

Të gjitha inspektoratet shtetërore japin llogari pranë tij. Sidoqoftë këto inspektorate i raportojnë në të njëjtën kohë edhe ministrit përkatës. Si rregull, çdo ministri ka një inspektorat. MMPAU *do të ketë një inspektorat, Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit* i cili do të përfshijë tre sektorë inspektimi, përkatësisht: Mjedisin, Pyjet dhe Peshkimin.

Inspektorati shtetëror i një funksioni të caktuar inspektimit (p.sh. mjedisi) do të krijohet në baze të një VKM-je. Kjo VKM do të përcaktojë varësinë institucionale, rregullat e organizimit dhe të funksionimit, funksionet e inspektimit, numrin dhe juridiksionin territorial të degëve, nëse do të ketë. Struktura dhe organika do të miratohen prej Kryeministrit (Neni 11).

Çdo inspektorat do të drejtohet prej një krye-inspektori, i emëruar nga Kryeministri me propozim të ministrit përkatës. Kriteret dhe procedurat për zgjedhjen, emërimin, vlerësimin e performancës, disiplinën dhe shkarkimin e krye-inspektorit do të përcaktohen me VKM.

Personeli i inspektoratit qendror edhe atij shtetëror do të punësohet në baze të ligjit mbi statusin e nëpunësit civil.

Ministria përkatëse do të mbështesë funksionimin efikas të inspektoratit shtetëror të saj, por kjo nuk do të përfshijë më drejtimin operacional të aktivitetit të inspektimit nga ministria, siç ka qenë deri më tani. Me mbështetjen e inspektoratit qendror, ministria përkatëse përcakton:

- Objektivat strategjike vjetore dhe afat-mesme të inspektoratit shtetëror
- Treguesit specifik të efikasitetit dhe të cilësisë së veprimtarisë së inspektimit.

Siç u përmend më sipër, baza e ISHM-së së ri vjen nga Ligji të ri mbi Inspektimin dhe në këtë ligj përshkruhet se Inspektoratet Shtetërore do të krijohen nëpërmjet një VKM.

Projekti i Asistencës Teknike SELEA është duke asistuar MMPAU për hartimin e kësaj VKM-je mbi funksionimin dhe organizimin. Në vijim të kësaj VKM-je do të nxirret një Urdhër i Kryeministrit lidhur me organizimin e burimeve njerëzore dhe financiare të nevojshme për vetë ISHM-në.

Raporti i tanishëm është dokumenti i përgatitur për procesin e riorganizimit të Inspektoratit aktual të Mjedisit në Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit në kontekstin e Ligjit të ri Nr. 10 433, dt. 16.6.2011 Për Inspektimin dhe ligjet nën-sektoriale për Mjedisin, Peshkimin dhe Pyjet.

Ky dokument është përgatitur në përputhje me kërkesat e VKM-së Nr. 474, dt. 16.6.2011 "Për përcaktimin e standardeve e të procedurës që duhet të ndiqen gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike", e cila parashtrohet procedurat dhe strukturat e organeve të reja. Në bazë të kësaj VKM-je, një organ – në këtë rast ISHM-ja nëpërmjet Ministrisë – duhet të dorëzojë dokumentacionin e mëposhtëm pranë Departamentit të Administratës Publike (DAP):

- a) Arsyet e detajuara për nevojën e ndryshimeve (këtë raport);
- b) Efektet financiare të cilat shoqërojnë ndryshimet e kërkuara (të përgatitura si Aneksi B);
- c) Përshkrimin e punës dhe kërkesat specifike për secilin pozicion pune të krijuar apo të prekur nga propozimi (përgatitur si Aneksi A);
- d) Analizën sasiore për burimet e nevojshme për të kryer disa funksione (përgatitur si seksion i këtij raporti)
- e) Një raport mbi pasojat që mund të sjellë ristrukturimi mbi punonjësit e institucioneve dhe kostot e personelit, si dhe një parashikim për rregullimin e punonjësve, pozicionet e punës të së cilëve preken si rezultat e këtij ristrukturimi (përgatitur si një seksion i këtij raporti).

Propozimi duhet të miratohet nëpërmjet një Urdhri të Kryeministrit i cili konfirmon organizimin e ri.

1 STRUKTURA AKTUALE E PËRGJITHSHME E IM-SË

Organigrama ekzistuese e IM-së aktuale nuk pasqyron funksionalitetin e strukturës së re në bazë të termave të legjislacionit të referuar. Funksionet e IM-së aktuale janë të ndara dhe të ndryshme nga ato të Inspektoratit të Peshkimit dhe Inspektoratit të Policisë Pyjore.

Gjithashtu, kjo organigramë nuk pasqyron strukturat që nevojiten për t'ju përgjigjur ndryshimeve në inspektim si rrjedhojë e reformës ligjore në funksionin e inspektimit, e cila përcakton mënyrat e reja të inspektimit dhe bashkon tre sektorë të veçantë inspektimi.

Zyrat rajonale të Inspektoratit të Mjedisit janë vlerësuar së fundmi në një raport të veçantë të SELEA-s (Vlerësim Institucional i ARM/IRM, Shkurt 2012, bashkëlidhur Raportit Fillestar të projektit).

Aktualisht, siç u përmend më sipër, këto Inspektorate Rajonale paraqiten si një nën-sektor i Inspektimit brenda kuadrit organizativ të Agjencisë Rajonale të Mjedisit.

Konkluzionet kryesore të vlerësimit tregojnë se ka mungesë burimesh (si financiare ashtu edhe njerëzore), për tu përmbushur përgjegjësitë dhe detyrat që zyrat rajonale (p.sh. IRM dhe ARM) pritet të ndërmarrin.

Aktualisht, personeli i IM-së përbehet nga 126 inspektorë, 4 prej të cilëve (1 jurist dhe 3 Inspektorë të Mjedisit) punojnë në Ministri dhe 31 punojnë nën juridiksionin e ARM-së Tirane. Një listë e plotë e personelit të IM-së dhe për 12 Qarqet është bashkëngjitur në Aneksin C. Ministrit do ti nevojitet të marre një vendim mbi ndarjen e personelit në zyrat rajonale të ARM dhe IRM .

2 PROPOZIM PËR NJË STRUKTURË TË RE ORGANIZATIVE TË ISHM-së

Ligji i ri për inspektimin solli mjaft ndryshime në konceptin e inspektimit:

1. Unifikimi dhe konsolidimi i organizmave të inspektimit nën konceptin “Një Inspektorat për çdo Ministri”;
2. Krijimi i një Inspektorati të përgjithshëm si një instrument për koordinimin e të gjitha inspektimeve të kryera në Territorin e Shqipërisë.
3. Një status i ri për Inspektoratet me synimin e rritjes së profesionalizmit, aftësive dhe kompetencave.
4. Një emër i ri për inspektoratet respektive kompetente të të gjitha ministrive. Ato tashme quhen Inspektorate Shtetërore.

Sipas Ligjit për Inspektimin, Inspektorati i Mjedisit do të përftojë statusin e institucioneve qendrore publike (Neni 10) Kreu III. Ai do të quhet Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe do të jetë përgjegjës për gjithë fushat e inspektimit të cilat varen prej MMPAU-së, duke përfshirë kështu edhe pyjet dhe peshkimin, edhe pse, në drejtori të veçanta.

Ndërkohë Neni 11 në pikat 2 dhe 3 përcakton se rregullat e organizimit, funksionimit, funksionet e inspektimit përcaktojnë dhe degët e juridiksionit territorial përcaktohen dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave nëpërmjet akteve nënligjore të veçanta, në përputhje me Ligjin mbi Inspektimin dhe ligje të tjera të veçanta me objekt mbrojtjen e mjedisit, siç është Ligji Për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligji Për Lejet e Mjedisit, etj.

1.1. STRUKTURA E PËRGJITHSHME PËR ISHM-në

Struktura e re organizative e ISHM-së do të jetë përgjegjëse për katër akte ligjore të reja të lidhura me ISHM-në dhe funksionin e vet. Ato paraqiten si me poshtë:

| | | |
|------------------------|--|-----------------------|
| Ligji Nr. 10433 | Ligji Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë | Datë: 16.06.11 |
| Ligji Nr. 10431 | Ligji Për Mbrojtjen e Mjedisit | Datë: 09.06.11 |
| Ligji Nr. 9385 | Ligji Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor | Datë: 04.05.05 |
| Ligji Nr. | Ligji Për Peshkimin (Draft) | Datë: |

Ligji Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë ofron kuadrin e përgjithshëm për procesin e inspektimit në Shqipëri ndërkohë që tre ligjet sektoriale parashikojnë detajet specifike që i përkasin procesit të inspektimit në kuadër të tre sektorëve të veçantë, ai i Pyjeve, Peshkimit dhe Mjedisit, domethënë:

- Funksionimi i Inspektoratit të Mjedisit është i përcaktuar në Seksionin 2, Nenet 62 deri në 66 të përfshira në Ligjin Për Mbrojtjen e Mjedisit.
- Funksionimi i Inspektoratit Pyjor është i përcaktuar në Nenin 12 të Ligjit Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor.
- Funksionimi i Inspektoratit të Peshkimit është i përcaktuar në Kapitullin 20 të Ligjit të ri Për Peshkimin.

Detyrat kryesore të ISHM-së së ri-organizuar sugjerohet të shpërndahen bazuar në katër drejtoritë që përshkruhen më poshtë;

Drejtoria e Inspektimit të Mjedisit

Roli kryesor i kësaj Drejtorie është të mbroje dhe të përmirësojë mjedisin. Ajo e kryen këtë duke qenë një rregullator i shkëlqyer i mjedisit, duke ndihmuar bizneset dhe industrinë të kuptojnë përgjegjësitë e tyre mjedisore, duke mundësuar që klientët të zbatojnë legjislacionin dhe praktikën e mira dhe të sigurojnë mjaft përfitime ekonomike prej praktikave të mira të mjedisit. Ajo mbron komunitetet duke rregulluar aktivitetet, të cilat mund të shkaktojnë ndotje të dëmshme.

Ajo mbron mjedisin dhe shëndetin njerëzor nëpërmjet punës së inspektoreve të vet, të cilët mbulojnë një fushe të gjere specialistesh përfshirë këtu, kiminë, ekologjinë, rregullimin e mjedisit, hidrologjinë, inxhinierinë, kontrollin e cilësisë, planifikimin, komunikimet, mbështetjen e biznesit dhe funksionet menaxhuese. 12 zyrat rajonale i mundësojnë asaj të punojë nëpër të gjithë Shqipërisë ndërkohë që Zyra Qendrore është në Tiranë.

Drejtoria e Inspektimit Pyjor

Funksioni primar i drejtorisë pyjore është të kryejë inspektime të zonave pyjore të Shqipërisë për të siguruar zbatimin e legjislacionit të administrimit të pyjeve, dhe për të siguruar përmbushjen e objektivave të pranuar të planeve të administrimit të pyjeve.

Raportimi i rregullt prej pronareve të pyjeve është faza e parë në monitorimin dhe inspektimin e administrimit pyjor, në planet e administrimit të pyjeve. Inspektimi në vend i veprimtarive të pronareve të pyjeve është një veprim thelbësor i mëtejshëm për të siguruar zbatimin e planeve të administrimit të pyjeve.

Procedurat e inspektimeve, kriteret e zbatimit, shpeshtësia kohore, logjistika e inspektimeve dhe procedurat e formatet e raportimeve duhet të përcaktohen në detaje brenda strategjisë së inspektimit pyjor. Sidoqoftë, mbledhja e rregullt dhe rutinë e informacionit mbi veprimtarinë, administrimin e pyjeve dhe vjeljet kanë një kosto.

Drejtoria e Inspektimit të Peshkimit

Kjo Drejtori siguron monitorimin efektiv dhe zbatimin e ligjeve të peshkimit detar. Ajo mbron zonat e çmuara detare dhe të peshkimit të Shqipërisë duke zbuluar shkeljet e rregullave të peshkimit, dhe duke monitoruar dhe inspektuar detin dhe portet. Ajo raporton sipas rregullit pranë autoriteteve të hetimit dhe ofron informacione mbi aktivitetet e peshkimit në zonat detare të Shqipërisë.

Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse

Kjo Drejtori merret me çështjet financiare dhe administrative, menaxhon burimet njerëzore dhe administron çështjet ligjore të ISHM-së.

Lidhur me sa më sipër, projekti do të hartojë një deklaratë të re misioni për ISHM-në e cila reflekton praktiken më të mirë të BE-së dhe që përfshin politiken e BE-së për zbatimin e ligjeve dhe të rregullave në të tre sektorët.

Struktura e përgjithshme e ISHM-së dhe struktura e propozuar mund të ilustron si në grafikun e mëposhtëm:



Task Forca e Mjedisit

Degët rajonale të ISHM-së, nën drejtimin e Kryeinspektorit të vet, do të krijojnë një task force të mjedisit *ad hoc* të aftë për t'iu përgjigjur emergjencave apo incidenteve serioze ndaj mjedisit. Task forcat në çdo dege rajonale do të përfshijnë inspektore të sektorit, të cilët janë specialistë të nivelit të parë dhe që drejtohet prej një drejtuesi të task forces së mjedisit, i cili do të jetë një prej drejtuesve të sektorit të degëve rajonale (në diagramën e mësipërme Task Forca e Mjedisit, e cila përfaqësohet nga një kuadrat me ngjyrë portokalli, nuk do të jetë një strukturë e përhershme, por do të jetë një strukturë e krijuar me qëllimin për të trajtuar çështje të emergjencave të mjedisit).

Këto Task Forca *ad hoc* do të jenë të afta të kryejnë një bashkëpunim ndër-sektorial dhe, nëse është e nevojshme, nuk do të jetë vetëm një strukturë e brendshme por mund të përfshijë agjenci të jashtme përkatëse, nëse natyra e veçantë e incidentit do të kërkonte një bashkëpunim të tillë.

Shqipëria do të ketë 12 Task Forca e Mjedisit të tilla, të cilat nuk do të jenë struktura të përhershme, por do të krijohen nëse shfaqet një situatë emergjence.

1.2. PËRSHKRIMI I DREJTORIVE

Përgjegjësitë e çdo Drejtorie të propozuar janë paraqitur në vijim:

Drejtoria e Inspektimit të Mjedisit

- Përgatit një rregullore të veçantë sektoriale për specifikat e funksionit të inspektimit për sa i takon kërkesave për burime njerëzore dhe financiare duke përfshirë një udhëzues mbi procesin e inspektimit.
- Përgatit një strategji të veçantë sektoriale inspektimi, shih përmbajtjen e sugjeruar në Aneks, dhe plan zbatimi bazuar në vlerësimin e rrezikut të mjedisit që vjen nga informacioni për numrat e instalimeve A dhe B në terren, pikat e nxehta dhe planet e menaxhimit të mbetjeve.

- Realizon zbatimin e planit të inspektimit.
- Mbledh dhe përpunon të dhënat e sistemit të raportimit të inspektimit të pikave dhe hedh të dhënat në një mjet elektronik të menaxhimit të inspektimit.
- Organizon një mision ndjekës mbi mos-përputhshmëritë (të vogla – të mëdha, të gjetura në terren).
- Jep këshilla nga praktikatat me të mira për instalimet.
- Identifikon aktivitetet ndotëse në rang juridiksioni rajonal.
- Përgatit plane veprimi lidhur me aktivitetet e identifikuar ndotëse në rang juridiksioni rajonal.
- Përgatit një Plan Menaxhimi Emergjencash për të verifikuar Përgjigjen e Menaxhimit të Mjedisit ndaj çdo Demi të Mjedisit që shkaktohet dhe masat zbutëse që do të ndërmerren në rast Emergjencash të Mjedisit. Një plan i tillë duhet të marre parasysh të dyja format e bashkëpunimit, atë brenda institucionit, dhe ndërmjet institucioneve.
- Përgatit raporte vjetore mbi funksionin e inspektimit për Krye Inspektorin dhe MMPAU-në.

Drejtoria e Inspektimit të Policisë Pyjore

- Përgatit një rregullore të veçantë sektoriale për specifikat e funksionit të inspektimit për sa i takon kërkesave për burime njerëzore dhe financiare duke përfshirë një udhëzues mbi procesin e inspektimit.
- Përgatit një strategji të veçantë sektoriale inspektimi dhe një plan zbatimi bazuar në procesin e vlerësimit të rrezikut ku i kushtohet vëmendje nivelit të ndikimit që shoqëron shkallen e cënueshmërisë ndaj një zone pyjore.
- Realizon zbatimin e planit të inspektimit.
- Mbledh dhe përpunon të dhënat e sistemit të raportimit të inspektimit në terren dhe hedh të dhënat në një mjet elektronik të menaxhimit të inspektimit.
- Organizon një mision ndjekës mbi mos-përputhshmëritë (të vogla – të mëdha, të gjetura në terren).
- Jep këshilla nga praktikatat me të mira për sektorin pyjor.
- Shqyrton Planet e Administrimit Pyjor dhe komenton përshtatshmërinë e tyre.
- Monitoron zbatimin e planet të administrimit pyjor prej pronareve të pyjeve.
- Verifikon Përgjigjen dhe Kompensimin ndaj çdo demi të shkakuar ndaj burimeve pyjore Shqiptare si rrjedhojë e aktiviteteve kriminale apo katastrofave natyrore.
- Përgatit një plan menaxhimi emergjencash për të zbutur efektet e aktiviteteve domethënëse të paligjshme dhe/ose të katastrofave natyrore, p.sh. zjarreve në pyje, të cilat dëmtojnë burimet pyjore Shqiptare. Një plan i tillë duhet të marre parasysh të dyja format e bashkëpunimit, atë brenda institucionit, dhe ndërmjet institucioneve.
- Përgatit raporte vjetore mbi funksionin e inspektimit për Krye Inspektorin dhe MMPAU-në.

Drejtoria e Inspektimit të Peshkimit

- Përgatit një rregullore të veçantë sektoriale për specifikat e funksionit të inspektimit për sa i takon kërkesave për burime njerëzore dhe financiare duke përfshirë një udhëzues mbi procesin e inspektimit.
- Përgatit një strategji të veçantë sektoriale inspektimi dhe një plan zbatimi bazuar në procesin e vlerësimit të rrezikut në lidhje me zonat e cënueshme të peshkimit, ku këto zona mund të jenë të cënueshme me tej prej aktiviteteve të paligjshme të peshkimit.
- Realizon zbatimin e planit të inspektimit.
- Mbledh dhe përpunon të dhënat e sistemit të raportimit të inspektimit në terren dhe hedh të dhënat në një mjet elektronik të menaxhimit të inspektimit.
- Organizon një mision ndjekës mbi mos-përputhshmëritë (të vogla – të mëdha, të gjetura në terren).

- Jep këshilla nga praktikat me të mira për komunitetin e peshkimit dhe aktoret e tjerë të interesit të industrisë.
- Përgatit një plan veprimi lidhur me zonat problematike të identifikuara.
- Përgatit një plan Përgjigje Emergjencash në rast ndotjesh apo incidentesh të tjera domethënëse të cilat kanë mundësinë të kërcënojnë apo të dëmtojnë rezervat e peshkut. Një plan i tillë duhet të marre parasysh të dyja format e bashkëpunimit, atë brenda institucionit, dhe ndërmjet institucioneve.
- Përgatit raporte vjetore mbi funksionin e inspektimit për Krye Inspektorin dhe MMPAU-në.

Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse:

- Menaxhon funksionet mbështetëse financiare
 - Përgatit dhe menaxhon buxhetin vjetor
 - Siguron monitorimin e shpenzimeve buxhetore
 - Siguron realizimin dhe raportimin e auditit vjetor
 - Siguron logjistiken për udhëtimet, etj.
- Menaxhon funksionet mbështetëse administrative
 - Mban inventarin e pajisjeve dhe mobilieve
 - Siguron mirëmbajtjen e godinave dhe funksionimin përkatës
 - Administrimi i BNJ dhe Zhvillimi i BNJ
- Menaxhon funksionet mbështetëse juridike
 - Harton një strategji për ISHM-në.
 - Ofron këshilla juridike ndaj drejtorive të tjera
 - Menaxhon përgjegjësitë e detyrimeve të mjedisit
- Funkzioni i Menaxhimit të Cilësisë
 - Mirëmban sistemin e akreditimit laboratorik
 - Realizon Garantimin e Cilësisë dhe Auditim të brendshëm për llogari të ISHM-së, MMPAU-së dhe Inspektoratit të Përgjithshëm

1.3. ANALIZAT SASIORE TË NEVOJAVE PËR PUNONJËS

Supozime

Me poshtë paraqiten supozimet e bëra për këtë proces:

- Numri i punonjësve do të mbetet konstant për përudhen afat-shkurtër dhe do të pasqyrojë numrat që janë të vendosur aktualisht në strukturat ekzistuese të inspektoratit për mjedisin, pyjet dhe peshkimin.
- Burimet financiare do të rriten ndjeshëm për të siguruar që Inspektorati Shtetëror i Mjedisit të mund të funksionojë në mënyrë efikase në përputhje me kërkesat e legjislacionit mbi Mbrojtjen e Mjedisit; Peshkimin dhe Pyjet.
- Uji do të përjashtohet nga funksionaliteti i ISHM-së

- I gjithë ISHM-ja do të lëvizë mbi një bazë operative në një Zyrë Qendrore në Tiranë plus 12 zyrat rajonale, një për çdo territor qarku.

Sfidat

Lidhur me sa me sipër dhe në bazë të kuadrit ligjor për Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, sfidat me të cilat përballet QSH janë të shumta. Sidoqoftë sfidat kryesore janë përshkruar si me poshtë:

- Financimi aktual për sa i takon mbrojtjes së mjedisit është i pamjaftueshem dhe i paqëndrueshem në kontekstin e funksionimit të legjislacionit të ri të propozuar.
- Pagat dhe statusi i punësimit për inspektorët duhet të trajtohet në mënyre që të sigurohet një qasje profesionale ndaj inspektimit të mjedisit në përputhje me kërkesat e legjislacionit dhe aspiratat strategjike.
- Burimet për funksionimin e fushave të caktuara kyçe të inspektoratit janë mjaft poshtë nivelit të nevojshëm, qoftë edhe për funksionin bazë të inspektoratit.
- Kapacitetet njerëzore për sa i takon funksionit modern të inspektoratit janë të ulëta.
- Për shkak të natyrës së reformës institucionale do të ketë sfida domethënëse ndaj bashkëpunimit ndër – institucional dhe atij brenda-institucionit për këtë organ të ri.
- Mbështetja vetëm në vet-monitorimin që kryen industria në Shqipëri është e pamjaftueshme dhe në vetvete nuk siguron pajtim të mirë mjedisor nga industria.

Shumë prej këtyre sfidave është e nevojshme të trajtohen sa me shpejt nga QSH, përndryshe ISHM-ja i ri shumë shpejt do të humbasë besueshmërinë e qytetareve të Shqipërisë.

Nevojat për Personel

Aktualisht është pranuar se Drejtoritë e reja të ISHM-së do të plotësohen me punonjës si vijon dhe nga numri ekzistues i punonjësve të inspektoratit:

| Drejtoritë | Anëtarët e Personelit |
|-----------------------------|----------------------------|
| Inspektimi i Mjedisit | 109 (përfshirë 4 në MMPAU) |
| Policia e Inspektimit Pyjor | 304 (përfshirë 4 në MMPAU) |
| Inspektimi i Peshkimit | 23 |
| Shërbimet Mbështetëse | 15 ¹ |

Për sa i përket ndarjes së këtij personeli, kjo ka nevojë të pranohet bazuar mbi një vlerësim më të thellë të nevojave të çdo sektori.

Kjo do të realizohet nga projekti SELEA në muajt e ardhshëm. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse do të ketë nevojë për personelin e mëposhtëm për të qenë në funksion të mbështetjes së funksionimit të përgjithshëm të ISHM-së:

| Pozicioni | Nr. i Personelit |
|------------------------------|------------------|
| Drejtor Drejtorie | 1 |
| Ekspert Ligjor | 3 |
| Ekspert Financiar | 2 |
| Ekspert i Burimeve Njerëzore | 2 |
| Ekspertët IT | 2 |

¹“Personeli nuk tejkalon 33% të numrit të personelit të ISHM-së siç kërkohet nga VKM Nr. 474, dt. 16.6.2011 “Për përcaktimin e standardeve e të procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike”.

| | |
|---------------------------------------|---|
| Punonjës i Informacionit për Publikun | 1 |
| Punonjës i Regjistrit | 1 |
| Ndihmës Administrativ | 3 |

Kjo përmbyll kërkesat për burime njerëzore për ISHM-në.

Propozimi për riorganizimin e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit

Në planin afatshkurtër, riorganizimi institucional i inspektoratit do të përfshijë të tre sektorët e tij: Mjedisin, Pyjet dhe Peshkimin, të cilët do të bashkohen nën Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit.

Kuadri ligjor që kjo të ndodhë tashmë është ngritur dhe në mënyrë që ky të funksionojë praktikisht duhet të hartohet një VKM për ngritjen e Inspektoratit të ri Shtetëror të Mjedisit dhe për përcaktimin e funksioneve dhe strukturave të tij.

Kjo VKM po hartohet nga Ministria në bashkëpunim me ekipin ligjor të Inspektoratit Qendror.

Në teori, hapi pasardhës do të ishte hartimi i një plan zbatimi për të siguruar një kalim sa më të lehtë nga struktura e vjetër tek e reja.

Një nga elementet kyç në një proces të tillë është transferimi i burimeve njerëzore dhe materiale, çështje që duhet të merret në konsideratë në kontekstin e funksioneve të reja të Inspektoratit Shtetëror.

Janë hedhur disa supozime në lidhje me riorganizimin e Inspektoratit Shtetëror dhe të përfaqësive të tij rajonale, përkatësisht:

- Numri i personelit nuk do të shtohet por ata do të fitojnë statusin e nëpunësit civil
- Nuk do të zhvendosen në zyra të reja
- Inspektorati i Pyjeve do të miratojë strukturën e re për Degët e veta Rajonale dhe nuk do të mbështetet më në zyrat në nivel rrethi.
- Inspektorati i Policisë Pyjore do të vazhdojë të japë mbështetje administrative për Degët Rajonale të Inspektoratit të ri Shtetëror.
- Do të sigurohen pajisje në mënyrë që të gjithë sektorët e inspektoratit të funksionojnë në mënyrë profesionale dhe efektive në përputhje me kërkesat ligjore.

Për sa i përket kësaj çështjeje, ekipi i vlerësimit teknik të projektit merr për të mirëqenë faktin se personeli do të shpërndahet në varësi të nevojës së perceptuar. Në rastin e Inspektoratit të Peshkimit supozohet që çështja kryesore për të do të jetë menaxhimi i zonave operative të mëposhtme:

- Porti i Shëngjinit
- Porti i Durrësit
- Porti i Vlorës
- Porti i Sarandës
- Liqeni i Ohrit

Supozohet, që personeli dhe burimet do t'u shkojnë këtyre zonave kyçe operative.

Për sa i përket, Inspektoratit të Mjedisit, ekipi i vlerësimit teknik të projektit ka vlerësuar se çështja kryesore për ta do të jetë inspektimi i industrive ndotëse dhe në këtë aspekt, ky ekip ka ngritur një bazë të dhënash për lejet mjedisore për tipet e aktiviteteve A dhe B. Tabela e mëposhtme tregon se ku janë shpërndarë këto leje në nivel qarku.

Në këtë moment në Shqipëri ka 936 leje mjedisore të tipit A e B, nga të cilat 99 janë të tipit A dhe 837 janë të tipit B.

| | Tipet e Lejeve | | | Niveli i Rrezikut në bazë të A-ve | Niveli i Rrezikut në bazë të A-ve & B-ve |
|------------------|----------------|------------|-----------|-----------------------------------|--|
| | A | B | C | | |
| Berat | 8 | 66 | | 4 | 8 |
| Dibër | 4 | 107 | | 10 | 2 |
| Durrës | 22 | 69 | 8 | 1 | 3 |
| Elbasan | 11 | 41 | 1 | 3 | 11 |
| Fier | 21 | 67 | 2 | 2 | 4 |
| Gjirokastrë | 1 | 39 | | 12 | 12 |
| Korçë | 5 | 66 | | 9 | 9 |
| Kukës | 5 | 75 | 1 | 8 | 5 |
| Lezhë | 6 | 71 | 5 | 6 | 6 |
| Shkodër | 6 | 47 | 1 | 7 | 10 |
| Tiranë | 6 | 118 | 10 | 5 | 1 |
| Vlorë | 4 | 71 | 5 | 11 | 7 |
| Gjithësej | 99 | 837 | 33 | | |

Përveç Inspektorateve të Peshkimit dhe Mjedisit, Inspektorati i Policisë Pyjore do të shpërndahet sipas parimit të shkallës së rrezikshmërisë të përdorur aktualisht nga Policia Pyjore, sipas të cilit burimet më të mëdha do t'u shkojnë për pyjet që janë më të kërcënuara.

Në këtë drejtim pra, ekipi i vlerësimit teknik të projektit propozon një riorganizim sipas strukturës të përshkruar në tabelën e mëposhtme.

Pavarësisht nëse Ministria e miraton, apo jo, këtë plan, apo atë që tashmë është hartuar, do të lindë nevoja për një plan të qëndrueshëm zbatimi, ku duhet të theksohen mënyrat se si këta elementë të ndryshëm do të bashkohen nën këtë institucion të ri dhe se si do të bëhet transferimi i burimeve njerëzore dhe materiale.

Do të ishte me vend që këtij plani zbatimi t'i paraprihet me miratimin e inventarit të aseteve që do të transferohen dhe të jemi të ndërgjegjshëm për ndikimin që do të ketë ky ristrukturim mbi Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, të Laboratorit të saj dhe 12 Agjencive të saj Rajonale.

| Nr. | Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave | Numri i personelit | Shpërndarja e Personelit në Nivel Qarku | | | | | | | | | | | | Gjithsej |
|-----|---|--------------------|---|---|---|-------------------------------|------------------------------------|------------------------|-------------------------------------|-------------------------|---------------------------------------|-----------|-----------|--------------------------|------------|
| | | | Qarku | Drejtori i degëve rajonale të inspektoratit | Inspektoratet e Mjedisit, Peshkimit dhe Pyjeve | | | | | | Specialistët e Shërbimeve Mbështetëse | | | | |
| | | | | | Drejtori i inspektoratit të policisë pyjore në rrethe | Inspektorët e policisë pyjore | Drejtori i inspektimit të mjedisit | Inspektorët e Mjedisit | Drejtori i inspektimit të peshkimit | Inspektorët e peshkimit | Financieri | Jurisit | OPGJ | Asistente Administrative | |
| 1. | Kryeinspektori | 1 | Berat | 1 | 1 | 6 | 1 | 8 | 0 | 0 | 1 | 1 | 1 | 2 | 22 |
| 2. | Ndihmës kryeinspektori | 1 | Diber | 1 | 1 | 19 | 1 | 12 | 0 | 0 | 1 | 1 | 2 | 2 | 40 |
| 3. | Shefi i Inspektoratit të Sektorit të Mjedisit | 1 | Durres | 1 | 1 | 6 | 1 | 12 | 1 | 4 | 1 | 1 | 2 | 2 | 32 |
| 4. | Drejtorja e Inspektoratit të Mjedisit | 5 | Elbasan | 1 | 1 | 20 | 1 | 10 | 1 | 2 | 1 | 1 | 1 | 2 | 41 |
| 5. | Shefi i Inspektoratit të Sektorit të Pyjeve | 1 | Fier | 1 | 1 | 6 | 1 | 12 | 1 | 2 | 1 | 1 | 1 | 2 | 29 |
| 6. | Drejtorja e Inspektoratit të Policisë Pyjore | 8 | Gjirokastr | 1 | 1 | 12 | 1 | 5 | 1 | 2 | 1 | 1 | 0 | 2 | 27 |
| 7. | Shefi i Inspektoratit të Sektorit të Peshkimit | 1 | Lezhe | 1 | 1 | 14 | 1 | 8 | 1 | 4 | 1 | 1 | 1 | 2 | 35 |
| 8. | Drejtorja e Inspektoratit të Peshkimit | 5 | Korce | 1 | 1 | 25 | 1 | 8 | 1 | 4 | 1 | 1 | 2 | 2 | 47 |
| 9. | Shefi i sektorit të shërbimeve mbështetëse | 1 | Kukes | 1 | 1 | 14 | 1 | 10 | 1 | 2 | 1 | 1 | 1 | 2 | 35 |
| 10. | Drejtorja e Shërbimeve mbështetëse | 14 | Shkoder | 1 | 1 | 25 | 1 | 8 | 1 | 2 | 1 | 1 | 2 | 2 | 45 |
| 11. | | | Vlore | 1 | 1 | 13 | 1 | 10 | 1 | 8 | 1 | 1 | 2 | 2 | 41 |
| 12. | | | Tirana | 1 | 1 | 17 | 1 | 20 | 1 | 4 | 1 | 1 | 1 | 2 | 50 |
| | | MMPAU total | | | | | | | | | | | | | |
| | Gjithsej | 38 | | 12 | 12 | 177 | 12 | 123 | 10 | 34 | 12 | 12 | 16 | 24 | 482 |

1.4. PËRSHKRIMET E DETYRAVE DHE NDIKIMET NDAJ PERSONELIT

Aneksat e mëposhtme janë përgatitur për të dokumentuar nevojat për plotësim me personel:

- Aneksi A – Përshkrimet e vendeve të punës
- Aneksi C – Lista e personelit ekzistues të IM-së si dhe të ARM/IRM-së së mëparshme.

Në bazë të kërkesave të Ligjit, duhet të hartohet një raport mbi pasojat që pritet të ketë krijimi i strukturës së ISHM-së ndaj personelit.

Personeli ekzistues

Lista e personelit ekzistues në të tre organet e mëparshme jepet në Aneksin C.

Pasoja të veçanta

Supozohet se ISHM-ja do të funksionojë me gati të njëjtin numër total punonjësish që është caktuar me parë, megjithëse i shpërndarë në njësi të ndryshme, me tepër se një, siç është rasti i tanishëm.

Pasojat e veçanta për punonjës të veçantë në këtë mënyre, nuk do të jenë shumë radikale, përveç ndryshimit të një pozicioni të punës, trajnim shtese dhe kërkesës së përgjithshme për statusin e nëpunësit civil (përveç personelit administrativ).

Në përgjithësi, transferimi i personelit që do të duhet të kryhet, do të behet nga organet e mëparshme përgjegjëse për inspektimin në lidhje me Peshkimin, Pyjet dhe Mjedisin për në Inspektoratin e ri Shtetëror të Mjedisit. Për më tepër, kjo do të kërkojë edhe transferimin e disa anëtarëve të personelit prej ARM – ve në ISHM.

Ligjet e reja mbi Pyjet dhe Peshkimin si dhe Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit përcaktojnë qartësisht ndarjen midis agjencive të mëparshme dhe inspektoratit të ri, dhe, në lidhje me këtë, do të nevojitet të kryhet një transferim i ish punonjësve të institucioneve të mëparshme në Inspektoratin e ri Shtetëror të Mjedisit.

Profile punë të reja në ISHM

Përshkrimet e vendeve të punës janë përgatitur për:

- Krye Inspektorin e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit
- Drejtuesi i Sektorit të Inspektoratit
- Inspektoret e çdo sektori

Negocimet individuale

Pritet që Drejtori i Inspektoratit të ketë negocime individuale me secilin apo me shumicën e pjesëtarëve të personelit. Negocimet pritet të rezultojnë në një ri-organizim optimal të brendshëm të vendeve të veçanta të punës lidhur me nevojat e përgjithshme për funksionimin e inspektoratit.

Aktualisht dhe në bazë të ligjit, i gjithë personeli jo-administrativ brenda ISHM-së do të marrë statusin e Nëpunësit Civil.

1.5. NDIKIMET FINANCIARE

Një panoramë e implikimeve buxhetore për funksionimin e një AKM-je të riorganizuar përfshihet në Aneksin B.

Ky buxhet përfshin tre elementë (1) Kërkesat për Investim; (2) Operacionet & (3) Pagat.

Është bërë një numër supozimesh lidhur me dispozitat financiare për ISHM-në, respektivisht:

- I gjithë personeli i inspektoratit do të ketë statusin e nëpunësit civil në bazë të legjislacionit të ISHM-së, prandaj pagat e tyre do të përputhen me atë status. Në këtë mënyrë është pranuar që paga e çdo inspektori do të rritet deri në €350.00 në muaj.
- Shërbimet e ofruara prej ISHM-së do të sigurohen dhe kontraktohen prej platformës aktuale operative drejt një platforme të re të reduktuar të një Zyre Qendrore në Tiranë dhe në 12 zyrat rajonale që janë të vendosura në territorin e secilit Qark.
- ISHM-ja do të vendoset në një godinë, e cila aktualisht është prone shtetërore dhe kështu nuk ka nevojë të marrë objekt me qira apo të paguajë qira si një zë në buxhet.
- Nivelet e shpenzimeve operative do të kenë kufi dhe këto nivele shpenzimesh me kufi në disa raste do të reflektohen në nivel zyrash, p.sh., materiale konsumi zyrash, dhe në disa raste të tjera do të reflektohen në nivel inspektori, si telefoni dhe shpenzime udhëtimesh.
- Kostot e investimeve do të mbulohen për një periudhë të përcaktuar kohore dhe QSH dhe projekti SELEA do të zhvillojnë një plan lidhur me këtë çështje si pjese e produktit të projektit të asistencës teknike.
- Në planin afat-shkurtër QSH do të sigurojë që ISHM-ja të ketë nivelin bazë të pajisjeve për të siguruar që inspektorët të mund të funksionojnë dhe të operojnë në një mjedis të sigurt pune.
- Investimet në sektorin pyjor për sa i përket automjeteve dhe uniformave nuk nevojiten në këtë moment dhe prioriteti për investim duhet për përdhën afat-shkurtër të fokusohet tek sektorët e mjedisit dhe të peshkimit.

Lidhur me sa me sipër është hartuar një buxhet dhe është bashkëlidhur Aneksit B të këtij raporti vlerësimi. Ky buxhet gjithashtu merr parasysh kontributin prej € 200,000.00 për këtë buxhet nga Qeveria e Republikës së Italisë.

ANEKSI A PËRSHKRIMET E VENDIT TË PUNËS

Emërtimi i Vendit të Punës: Krye Inspektor i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit

Vendi i punës i parashikuar: 1

Vendndodhja: Zyra Qendrore Tirane

Përshkrimi i Vendit të Punës:

Drejtuksi i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit do të sigurojë se standardi i inspektimit të mjedisit në Shqipëri jo vetëm do të arrihet, por do të përmirësohet, në përputhje me objektivat dhe qëllimet strategjike. Kjo do të përfshijë zbatimin e vazhdueshëm të politikave respektive qeveritare dhe do të përfaqësojë sfidat kryesore të funksionit të inspektimit për Krye Inspektorin e Shqipërisë. Drejtuesi do të jetë përgjegjës për zbatimin e Misionit dhe të Strategjisë së ISHM-së, si dhe për paraqitjen e kërkesave për burime tek Krye Inspektori. Drejtori do të udhëheqë forcimin e kapacitetit të ISHM-së dhe do të sigurojë një zhvillim të vazhdueshëm të organizatës për të qenë moderne, efikase dhe në përputhje me objektivat strategjike. Ai duhet të jetë shembulli më i mirë i udhëheqjes dhe menaxhimit më të mirë për tu ndjekur nga pjesa tjetër e organizatës.

Është e detyrueshme tashme që Drejtori të garantojë që ISHM-ja të ofrojë një shërbim me cilësi të lartë si ndaj publikut ashtu edhe ndaj industrisë, dhe se aktivitetet e inspektimit pasqyrojnë besueshmërinë si të ISHM-së ashtu edhe të personelit.

Mjedisi i Punës:

Kjo është kryesisht punë zyre, sidoqoftë mund të ketë raste veçanërisht për sa i përket emergjencave ku mund të ketë aktivitete në terren. Puna në zyrë kryhet në një mjedis të brendshëm zyre. Për këtë pozicion do të nevojiten udhëtime të brendshme si dhe mund të ketë nevojë edhe për udhëtime jashtë shtetit.

Përgjegjësitë Kryesore:

- Miraton dhe kontribuon për dokumentin e strategjisë së ISHM-së
- Miraton planet e inspektimit të ISHM-së për të lehtësuar përgatitjen e strategjisë sektoriale të inspektimit.
- Miraton raportet javore, mujore dhe vjetore të inspektimit për tu paraqitur pranë Ministrisë dhe kur kërkohet edhe pranë Krye Inspektorit.
- Zhvillon dhe forcon lidhjet e komunikimit me aktoret institucionale të interesit si brenda institucionit ashtu edhe atyre ndërinstitucionalë të jashtëm.
- Miraton programin vjetor të inspektimit, i cili përfshin analizën e detajuar financiare në lidhje me kërkesat për burime njerëzore dhe financiare për të zbatuar programin.
- Miraton deklaratat për shtyp dhe kryen takime me mediat duke dhënë përmbledhje informative mbi çështje të veçanta të mjedisit.
- Zhvillon lidhje me shoqërinë civile dhe ofron informacion për përdorim publik sipas nevojave.

Aftësitë e Kërkuara:

- 15 + vite eksperience në inspektimin e mjedisit, pese vite prej të cilave t'i ketë kaluar në nivel drejtuesi të lartë

- Eksperience në Administrim Departamenti dhe Auditim të Brendshëm
- Eksperience në Sisteme të Menaxhimit të Cilësisë
- Zhvillim i Strategjive të Inspektimit
- Zhvillim i Planeve të Inspektimit dhe Programeve të Punës
- Aftësi Kompjuterike
- Aftësi të shkëlqyera të menaxhimit dhe motivimit të personelit
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi me gojë dhe me shkrim
- Eksperience lidhur me punën me median

Emërtimi i Vendit të Punës: Drejtues i Sektorit të Inspektoratit

Pozicionet e parashikuara: 3

Vendndodhja: Zyra Qendrore Tirane

Përshkrimi i Punës:

Roli i Drejtuesit të Sektorit të Inspektoratit është të menaxhojë funksionalitetin e Sektorit të Inspektoratit si nga ana e funksionalitetit administrativ ashtu edhe të atij operacional. Në lidhje me Inspektoratin Kombëtar të Mjedisit, Drejtuesi i Sektorit të Inspektoratit do të raportojë drejtpërdrejt Drejtuesit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe do të zhvillojë lidhje të forta operationale me partneret e tij në dy inspektoratet sektoriale të tjera. Për më tej, lidhje të forta do të zhvillohen midis sektorëve brenda vetë ISHM-së për të siguruar një përfaqëse të përbashkët ndaj inspektimit.

Si një pozicion i nivelit drejtues, ky kërkon vendosje marrëdhëniesh punë me autoritetet rregullatore, dhe një praktike të integruar dhe njohje të politikave përkatëse sektoriale, strategjive, rregulloreve, kërkesave ndaj raportimit, standardeve dhe kodeve të praktikës. Roli do të përfshijë garantimin që strategjia e sektorit të inspektimit kryhet në një kontekst praktik nëpërmjet një koordinimi efikas të burimeve njerëzore dhe financiare të disponueshme. Kjo do të përfshijë zhvillimin e planeve gjithëpërfshirëse të inspektimit, të cilat do t'i komunikohen të gjithë anëtarëve të personelit.

Mjedisi i Punës:

Kjo është kryesisht punë zyre, sidoqoftë mund të ketë raste veçanërisht për sa i përket emergjencave ku mund të ketë aktivitete në terren. Puna në zyrë kryhet në një mjedis të brendshëm zyre. Për këtë pozicion do të nevojiten udhëtime të brendshme si dhe mund të ketë nevojë edhe për udhëtime jashtë shtetit.

Përgjegjësitë Kryesore:

- Harton plane inspektimi dhe plane pune për të lehtësuar zbatimin e strategjisë së sektorit të inspektimit.
- Përgatit raporte javore, mujore dhe vjetore inspektimi për Krye Inspektorin e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit.
- Zhvillon dhe forcon lidhjet e komunikimit me aktoret institucionale të interesit si brenda institucionit ashtu edhe atyre ndërinstitucionalë të jashtëm.
